

MBËSHËTETJA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË UJIT (EUSIWM)

Konteksti

Agjencia Austriake për Zhvillim (AAZH) zbatoi projektin e financuar nga BE "Mbështetje e Bashkimit Evropian (BE) për Menaxhimin e Integruar të Ujrave (EUSIWM)" në Shqipëri. Duke u mbështetur në Programin e Veprimit IPA 2016 për Shqipërinë për Mbështetjen e Menaxhimit të Ujrave, dhe në përputhje me strategjinë vendase të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim për Shqipërinë (2015 - 2020), objektivat e përgjithshme të këtij projekti kontribuan në rritjen e zbatimit të Reformës Kombëtare të Ujit dhe progresit të Shqipërisë drejt kërkesave të legjislacionit të BE-së për ujërat. Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU) ishte një përfitues i drejtpërdrejtë i projektit.

Ky projekt ndihmoi në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e sektorit në përputhje me politikat e BE-së dhe konsolidoi përpjekjet e mëparshme në këtë drejtim. Instituti i Kërkimeve Urbane mbështeti kuadrin e ri ligjor në fushën e menaxhimit të ujërave, i përmirësuar në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në fakte dhe i zbatuar në përputhje me kërkesat e BE-së.

Objektivat e Projektit

Objektivat specifikë të projektit ishin:

- Të bëhej një analizë e instrumenteve ekonomike që janë në përdorim në shtetet e Evropës Juglindore në fushat e parandalimit të mbetjeve dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiake dhe komerciale;
- Mbështetja e përpilimit të një kuadri ligjor të ri mbi menaxhimin e ujit, në përputhje me direktivat dhe kërkesat e BE-së.

Produktet

- Legjislacioni kombëtar për ujërat (aktet ligjore parësore dhe dytësore) i mbledhur si informacion për t'u futur në databazën e të dhënave të legjislacionit, që është në zhvillim të vazhdueshëm;
- Identifikimi i mangësive ligjore;
- Vlerësimi i kontrollit të përputhshmërisë;
- Hartimi i akteve nënligjore duke patur parasysh ndikimet dhe konkluzionin pas rekomandimeve të propozuara për kornizën ligjore dhe institucionale;
- Asistencë për përgatitjen e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator për aktet ligjore të përgatitura nga projekti dhe mbështetje për AMBU në këtë proces;
- Mbështetje shtesë ad-hoc për ekspertë të tjerë të projektit, p.sh. analizë institucionale dhe ekonomike mbi ndikimin socio-ekonomik të ndryshimeve ligjore të propozuara.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Bashkimi Evropian
Agjencia Austriake për Zhvillim

PARTNERËT:

- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- Agjencia Austriake për Zhvillim
- Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Lumore

KOHËZGJATJA:

01/09/2019 - 31/08/2021

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

